



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2024:120929
Datë: 01.10.2024
Numri i dokumentit: 06236119

2024:120930

Gjykata Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Armend Ahmeti, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Xh.O nga Ferizaj, me nr. personal ... të cilën e përfaqëson av. Visar Musa nga Ferizaj, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve S... me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensim dëmi, vlera e kontestit e pacaktuar, jashtë seance me datë 01.10.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET E TËRHEQUR padia me shenjë 2024: 120930, e paditëses Xh.O nga Ferizaj, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve S... me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensim dëmi, vlera e kontestit e pacaktuar.

A r s y e t i m

Paditësja, të cilën e përfaqëson av. Visar Musa nga Ferizaj ka ushtruar padi në këtë gjykatë më dt. 24.04.2024, kundër të paditurës, për çështjen objekt kontesti kompensim dëmi.

Përfaqësuesi i paditëses av. Visar Musa nga Ferizaj me parashtrësën e dt.30.09.2024, e ka njoftuar gjykatën se e tërheqë padinë në këtë çështje juridike kontestuese për arsye se me të paditurën kanë lidhur ujdi jashtëgjyqësore. Meqë në gjykatë nuk ka mbërritur përgjigja në padi e të paditurës, gjykata nuk ia dërgoi parashtrësën e paditëses për deklaram të njëjtës.

Gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 261 e lidhur me nenin 387.1 pika c të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm

Datë 01.10.2024

Gjyqtari,
Armend Ahmeti

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.